



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 shkurt 2021
Nr.ref.:RK 1711/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI44/20, KI83/20 dhe KI102/20

Parashtrues

Besnik Kavaja

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Ac.nr.1496/2020] të 29
prillit 2020, të Gjykatës së Apelit, dhe Aktgjykimit [GSK-KPA-A-005/19]
të 11 marsit 2020, të Gjykatës Supreme**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë dorëzuar nga Besnik Kavaja, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga avokati Teki Bokshi sa i përket kërkesës KI44/20.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Ac.nr.1496/2020] të 29 prillit 2020, të Gjykatës së Apelit, dhe Aktgjykimin [GSK-KPA-A-005/19] të 11 marsit 2020, të Gjykatës Supreme.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 1 të Protokollit 1, nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt], nenin 13 [E Drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Në të njëjtën kohë, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij KI44/20 kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të caktojë masën e përkohshme me të cilën do të vendoste *“që të ndalohet Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës që të më dëboj nga banesa, deri sa të zgjidhet kjo kërkesë”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI44/20 në Gjykatë.
7. Më 2 mars 2020, Kryetarja e Gjykatës e caktoi për rastin KI44/20 gjyqtaren Remzije Istrefi Peci, gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka Nimani dhe Safet Hoxha.
8. Më 6 mars 2020, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës KI44/20.

9. Më 9 mars 2020, Gjykata njoftoi Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKKVP) për regjistrim të kërkesës KI44/20.
10. Më 2 prill 2020, përfaqësuesi i parashtruesit përmes e-mailit dorëzoi në Gjykatë një parashtrësë.
11. Më 1 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI83/20.
12. Më 12 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI83/20 me kërkesën KI44/20.
13. Më 16 qershor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për bashkimin e kërkesave KI44/20 dhe KI83/20.
14. Më 25 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën KI102/20.
15. Më 1 korrik 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit dhe AKKVP-në për regjistrim dhe bashkim të kërkesave KI44/20 me KI83/20.
16. Më 2 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI102/20 me kërkesat KI44/20 dhe KI83/20.
17. Më 6 korrik 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesave për regjistrim dhe bashkim të kërkesës KI102/20 me kërkesat KI44/20 dhe KI83/20.
18. Më 6 korrik 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrim dhe bashkim të kërkesës KI102/20 me kërkesat KI44/20 dhe KI83/20.
19. Më 12 gusht 2020, Gjykata njoftoi AKKVP-në për regjistrim dhe bashkim të kërkesës KI102/20 me kërkesat KI44/20 dhe KI83/20.
20. Më 12 gusht 2020, Gjykata i dërgoi një shkresë parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta sjellë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit.
21. Më 19 gusht 2020, AKKVP dorëzoi në Gjykatë komentet e tyre në lidhje me kërkesat.
22. Më 24 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
23. Më 10 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

24. Më 5 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një kërkesë e cila u regjistrua me nr.KI198/19.
25. Më 16 janar 2020, Gjykata vendosi që kërkesa KI198/19 të shpallet e papranueshme sepse nuk ishte *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.
26. Bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur në lëndë e kontestit është banesa e cila gjendet në Prishtinë në adresën Bregu i Diellit Hyrja III, kati 2-të, numër 13, i cili ka qenë në pronësi të Korporatës Energjetike të Kosovës-KEK-ut.
27. KEK-u i ndau këtë banesë për shfrytëzim punëtorëve të tij dhe vetë prona e kontestuar në periudha të ndryshme kohore ka qenë në posedim të dy punëtorëve të KEK-ut.
28. Në qershor 1999, punëtori i KEK-ut me inicialet R. S., , kishte iniciuar procedurë pranë Komisionit për Çështje Pronësore Banesore (në tekstin e mëtejme:KÇPB), për vërtetimin e pronësisë dhe shpërnguljen e personit që i kishte uzurpuar banesën. Kërkesa tek KÇPB-ja ishte regjistruar si kërkesë me numër [DS 002009].
29. Në të njëjtën kohë punëtori tjetër i KEK-ut me inicialet XH.G. për të njëjtën pronë kontestuese gjithashtu paraqiti kërkesë [DS 003164] për vërtetimin e pronësisë pranë KÇPB-së.
30. Më 30 prill 2005, KÇPB përmes vendimit [HPCC/D/180/2005/A&C] kishte aprovuar kërkesën e kategorisë C të punëtorit të KEK-ut me initiale R.S. dhe kishte vendosur që t'i jepet posedimi mbi pronën kontestuese. Ndërsa sa i përket kërkesës [DS 003164] të punëtorit të KEK-ut me inicialet XH.G. kishte refuzuar kërkesën e tij të kategorisë A ku kishte theksuar se: "*paraqitësit asnjëherë nuk kanë lidhur kontratë mbi shfrytëzimin apo qiranë me ndërmarrjen publike banesore dhe kurrë nuk e kishte marrë posedimin e banesës*".
31. Pas këtij vendimi punëtori i KEK-ut me inicialet R.S. ndërroi jetë dhe atë e trashëgoi gruaja e tij e ve D.S.
32. Më 25 tetor 2005, M.H.K. vëllai i parashtruesit të kërkesës si blerës lidhi kontratë mbi shitblerjen e banesës në fjalë me të vejën D.S. si shitëse, e cila vërtetohet në Gjykatën Komunale në Prishtinë nën numrin Vr. nr. 83388/2005 më 25.10.2005.
33. Më 18 nëntor 2005, përmes kontratës mbi dhuratën, vëllai i parashtruesit të kërkesës M.H.K. me anë të kontratës mbi dhuratën e transferoi pronën e patundshme kontestuese në fjalë në pronësi të parashtruesit të kërkesës.
34. Në ndërkohë brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh, punëtori i KEK-ut me initiale XH.G. parashtroi ankesë kundër vendimit [HPCC/D/180/2005/A&C] të 30 prillit 2005 të KÇPB-së.

35. Më 11 dhjetor 2006, KÇPB përmes vendimit [HPCC/REC/85/2006/C] e miratoi kërkesën e kategorisë A [DS 003164] të punëtorit të KEK-ut me inicialet XH.G. dhe e ndryshoi vendimin e Komisionit [HPCC/D/180/2005/A&C] të 30 prillit 2005.
36. KÇPB në vendimin [HPCC/REC/85/2006/C] e 11 dhjetorit 2006 ndër të tjera theksoi: *"Komisioni me vendimin e tij HPCC/D/180/2005/ A&C i datës 30 prill 2005 kishte vendosur të refuzojë kërkesën e kategorisë A Nr. DS003164 bazuar në atë se Paraqitësi kishte dështuar të bëjë kontratën mbi shfrytëzim me Ndërmarrjen Publike Banesore ("NPB") dhe të aprovoj kërkesën e kategorisë C Nr. DS002009. Pas njoftimit mbi vendimin e Komisionit, Paraqitësi A, si palë kërkuese, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim brenda afatit 30 ditësh. Pala kërkuese pohon se kishte hyre në pronën e kërkuar pasi që kishte pranuar vendimin mbi ndarjen nga NPB. Pala kërkuese gjithashtu pohon se ka paraqitur kërkesë për të bërë kontratën mbi shfrytëzim me NPB, por ishte penguar për të bërë ashtu bazuar në diskriminim. Si plotësim pala kërkuese pohon se ishte burgosur në vitin 1989 për arsye politike dhe pasi që ishte liruar nga burgu ishte larguar nga puna. Në mbështetje të pohimeve të tij pala kërkuese si dëshmi të re ka paraqitur dëftesën e qirasë, vendimin mbi ndarjen dhe protokollin mbi dorëzimin e qelësive të apartamentit nga NPB. Drejtorati ka njoftuar Paraqitësin C mbi kërkesën për rishqyrtim, por ai ka dështuar të përgjigjet. Komisioni me kujdes ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara dhe konkludon se dëftesa e paraqitur mbi qiranë, e cila është vërtetuar pozitivisht nga Drejtorati, dëshmon se pala kërkuese i ka paguar qira NPB-së për pronën e kërkuar. Në këto rrethana, në rastet kur Paraqitësi A kishte paguar qira dhe NPB ka pranuar qiranë, Komisioni me herët kishte vendosur se Paraqitësi A duhet të konsiderohet se ka përmbushur kriteret se ka pasur kërkesë mbi shfrytëzim mes paraqitësit dhe NPB-se (Shih HPCC1D1223/2005/A&A në paragrafin 7 dhe HPCC/235/2005 në paragrafin 10). Rrjedhimisht kërkesa e kategorisë A qëndron të aprovohet. Në këto rrethana Komisioni duhet të përcaktoj të drejtat përkatëse të palëve në lidhje me pronën kontestuese në dritën e dispozitave përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, dhe veçanërisht në nenet 3.3 dhe 4 -të saj".*
37. Vendimi ishte bërë res judicata në vitin 2006.

Faktet e rastit KI44/20 dhe KI83/20

38. Më 27 shtator 2019, Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës përmes vendimit KPCC/D/COMP/01/2019 urdhëroi që (a) pronësia e paraqitësit të kërkesës së kategorisë "A" në lidhje me pronën e kërkuar, të regjistrohet në të dhënat publike përkatëse; (b) çdo person tjetër i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30(tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhëri; dhe (c) nëse çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme dëshiron të përmbush urdhërin për lirim të pronës brenda afatit të dhënë, ata të dëbohen nga prona.
39. AKKVP përmes një njoftimi mbi lirim të pronës e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se duhet të liroi pronën dhe t'ia dorëzoi AKKVP-së para datës 28 shkurt 2020.

40. Më 18 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar kërkesëpadi për pengim posedim me propozim për masë të sigurisë kundër AKKVP-së, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
41. Më 19 shkurt 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.3971/19] refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për pengim posedim, po ashtu refuzoi si të pabazuar edhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit.
42. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [C.nr.3971/19] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Themelore me pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimi që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktvendimi i atakuar të ndryshohet.
43. Më 29 prill 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.1496/2020] refuzoi si të pathemeltë ankesën e të autorizuarit të parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore.

Faktet e rastit KI102/20

44. Më 18 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar edhe një ankesë kundër Vendimit të KÇPB-së [HPCC/REC/85/2006] të 11 dhjetorit 2006, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës- Dhomës së Posaçme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare për Krahasinin dhe Verifikimin e Pronës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
45. Më 21 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit pranë Gjykatës Supreme.
46. Më 11 mars 2020 Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [GSK-KPA-A-005/19] hodhi poshtë si të palejuar ankesën dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, me arsyetimin se nuk ka juridiksion për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me vendimin e atakuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

47. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, me nenin 1 të Protokollit 1, nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt], nenin 13 [E Drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.
48. Parashtruesi i kërkesës pretendon se KÇPB e ka përjashtuar nga procedura atë dhe palën R.S., dhe me këtë i është shkelur e drejta e qasjes në drejtësi për arsye se siç pohon ai, atyre i është pamundësuar atakimi i vendimit [HPCC/REC/85/2006] të 11 dhjetorit 2006 të KÇPB-së, për arsye se ai nuk ka

qenë në dijeni për nxjerrjen e vendimit në fjalë deri më 25 tetor 2019 kur është njoftuar se Agjencia për Verifikim dhe Krahësim e Pronës se ka nisur procedurën për zbatimin e vendimeve dhe është ftuar që ta lirojë banesën.

49. Lidhur me këtë parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykatat e rregullta nuk e kanë marrë për bazë faktin se ai nuk ishte njoftuar asnjëherë nga ana AKKVP-së lidhur me vendimin e lartëcekur të KÇPB-së dhe se me këtë i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
50. Ai pretendon se Gjykata dhe “Habitati” nuk kanë mandat që ta dëbojnë nga banesa sepse ai thekson se në banesë nuk ka hyrë me dhunë mirëpo ka një kontratë valide, dhe se pronën në fjalë e ka fituar *“në bazë të posedimit ligjor dhe të ndërgjegjshëm konform dispozitës vendore, bazuar në nenin 22 të Kushtetutës”*, dhe se shpërngulja nga banesa është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së.
51. Parashtruesi i kërkesës thekson se *“ unë kam fituar të drejtën e pronës me punë juridike, me kontratat e shitblerjes dhe dhurimit dhe me mbajtje, si mbajtës i ndërgjegjshëm si me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet themelore pronësore juridike të RFJ ashtu edhe me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat sendore. Nga ana tjetër, nëse personi XH.G qenka diskriminuar, për të eliminuar pasojat e diskriminimit të tij nuk mundet, nuk duhej që unë të diskriminohem. Të përmendurit do duhej të akordohej kompensimi i plotë, dhe të mos krijohen këto turbulenca tronditëse dhe diskriminuese ndaj meje”*. Ai pretendon se me injorimin e aplikimit të dispozitave të lartëpërmendura ai është diskriminuar.
52. Më tej parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme dhe “Habitati” kanë aplikuar dispozitat ligjore përkatëse në mënyrë të gabuar dhe arbitrare, me çka kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
53. Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, parashtruesi kërkon nga Gjykata ndalimin e ekzekutimit të vendimit [HPCC/REC/85/2006/C] të 11 dhjetorit 2006 të KÇPB-së nga ana e AKKVP-së.
54. Në fund parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë kundër kushtetues vendimin [HPCC/REC/85/2006/C] e 11 dhjetorit 2006 të KÇPB-së, vendimin përfundimtar KPCC/D/COMP/01/2019 të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës, Aktvendimin e Gjykatës Themelore [C.nr.3971/19] të 19 shkurtit 2020, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.1496/2020] të 29 prillit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [GSK-KPA-A-005/19] të 11 marsit 2020, për shkak të *“shkeljeve të garancioneve kushtetuese”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

55. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

56. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet neneve 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë përcaktojnë:

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

57. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

58. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.1496/2020] të 29 prillit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [GSK-KPA-A-005/19] të 11 marsit 2020; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

59. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

60. Gjykata rikujton se në lidhje me rastin e parashtuesit të kërkesës janë zhvilluar dy procedura:

- a) procedura për refuzimin e padisë për pengim posedim;
- b) procedura e zhvilluar pranë Gjykatës Supreme

61. Prandaj, Gjykata gjatë vlerësimit të pranueshmërisë, këto dy procedura do t'i trajtojë ndaras.

a) Procedura për refuzimin e padisë për pengim posedim;

62. Në lidhje me këtë procedurë, Gjykata vëren se, në thelb, të gjitha pretendimet e parashtuesit të kërkesës kanë të bëjnë kryesisht me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Lidhur me këtë, parashtuesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij Gjykatat kanë bërë vërtetim të gabuar të fakteve si dhe interpretim të gabuar të ligjit.
63. Lidhur me këto pretendime, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për vërtetim të gabuar të fakteve dhe interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk hyjnë në jurisdiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund të i shqyrtojë ato. (Shih rastin e Gjykatës nr. K106/17, parashtues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; rastin K122/16, parashtues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; dhe K149/19 parashtues *Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 tetorit 2019, paragrafi 47).
64. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në jurisdiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: K170/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; K106/17, cituar më lart,

paragrafi 37; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48).

65. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 49).
66. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjedhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
67. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerret masa kur argumentohet se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës. (Përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdoruara aty).
68. Në këtë kontest, Gjykata vëren që në rrethanat e rastit konkret, çështja esenciale ndërlidhet me pretendimin e parashtruesit se ai nuk është njoftuar asnjëherë për nxjerrjen e vendimit nga ana e KÇPB-së, dhe me këtë i është pamundësuar atakimi i këtij vendimi, po ashtu ai pretendon se AKKVP përmes veprimeve të tyre kanë kryer akt të pengim posedimit. Siç u cek më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykatat kanë aplikuar dispozitat ligjore në mënyrë të gabuar dhe arbitrare. Në anën tjetër, gjykatat e rregullta pasi kanë vlerësuar secilën provë veq e veq kanë ardhë në përfundim se kërkesë padia dhe propozimi për masë të përkohshme të parashtruesit të kërkesës janë të pa bazuara. Gjykatat e rregullta, më tej kanë theksuar se organet kompetente në këtë rast AKKVP gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të ligjshme nuk kryejnë akte të pengim posedimit.
69. Më tej parashtruesi i kërkesës pohon se vendimi i kontestuar i KÇPB-së [HPCC/REC/85/2006/C] i 11 dhjetorit 2006 nuk i është dorëzuar atij, mirëpo Gjykata vërteton se edhe pse parashtruesi i kërkesës asnjëherë nuk ka qenë palë në procedurat të cilat përpiqet t'i kontestoj dhe se autoritetet kompetente asnjëherë nuk kanë qenë të obliguara ta informojnë në lidhje me procedurat në të cilat nuk ka marrë pjesë si palë, prapë se prapë nuk qëndron pohimi i parashtruesit se ai nuk është njoftuar me vendimin e KÇPB-së, për arsye se kjo

vërtetohet nga përgjigjja e dërguar nga ana e AKKVP-së, ku ceket se “lidhur me vendimin janë informuar të dy palët në procedurë dhe se më 24 prill 2007 një kopje e vendimit është dërguar në pronë me qëllim të njoftimit të banuesit aktual, konkretisht ankuesit”.

70. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregulla kishin adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit së kërkesës, që ndërlidhen me (i) pengim posedimin ; dhe (ii) propozimin për masë të sigurisë.
71. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit të saj [C.nr.3971/19] të 19 shkurtit 2020, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Gjykata, në rastin konkret pasi ka konstatuar gjendjen faktike, me përshkrim si me lartë, ka ardh në përfundim për pathemelësine e kërkesëpadise mbështetur ekskluzivisht në rrethanën se organet kompetente gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të ligjshme nuk kryejnë akt të pengimit të posedimit. Pra, në këtë rast pathemelesia e kërkesëpadise është e pacaktuar nga fakti se veprimet e caktuara në këtë rast për të cilat paditësi pretendon se kualifikohen si akt i pengim posedimit, janë ndërmarr nga një organ kompetent për veprimet e tilla, dhe deri me tani në asnjë procedurë nuk është konfirmuar se ato veprime kanë qenë të paligjshme. Në rastin konkret organi ka vepruar brenda kompetencave dhe me akte perkatëse paraprakisht e ka njoftuar paditësin dhe e ka urdheruar për lirin e prones. Sipas vlerësimit të gjykatës veprimi i të paditurës është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe në këtë rast sipas gjendjes faktike të konstatuar nga gjykata, palës paditëse nuk mund t'i ofrohet mbrojtje gjyqësore me përmbajtjen e propozuar ndaj të paditës e me referencë në dispozitat materialo-juridike të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, nga neni 113 i këtij ligji. Nga kjo rezulton se veprimet e të paditurës janë marre në kuadër të fushë veprimtarisë së saj , ' të përcaktuar me ligje, dhe nuk mund të konsiderohen veprime arbitrare dhe të detyrohen të përmbahen nga veprimet e saj në funksion të mandatit sepse do të vije deri te situatat e pamundësise së përmbushjes së detyrimeve të saj, e që janë përgjegjësi ekskluzive të përcaktuara me ligje, për të gjitha keto arsye të lartcekura, u vendos si në piken -I-dhe -II-, të dispozitivit të këtij aktvendimi.”

72. Duke adresuar pretendimet e njëjta, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të saj [Ac.nr.1496/2020] të 29 prillit 2020, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Gjykata ankimore, vlerëson se aktvendimi i atakuar është në tërësi i drejtë dhe i ligjshëm dhe rrjedhimisht nuk është i përfshirë në shkellje të dispozitave përkitazi me arsyetimin e aktvendimit, për shkak se arsyetimi i aktvendimit në këtë rast i referohet me saktësi fakteve vendimtare, provave të administruara, vlerësimit për provat dhe mënyrës se si ka ardhur gjykata në përfundimin se kërkesëpadia është e pathemeltë. Në këtë kontekst gjykata ankimore nuk i pranon pretendimet e të autorizuarit të paditësit për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak se provat e administruara gjykata e shkalles së parë në

mënyrë të plotë dhe objektive e ka konstatuar gjendjen faktike, me përshkrim si më lartë. Në rastin konkret ashtu siç ka theksuar gjykata e shkallës së parë përfundimi për pathemelësinë e kërkesëpadisë mbështet ekskluzivisht në rrethanën se organet “kompetente” gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre nuk kryejnë akt të pengim posedimit, pasi që të njëjtat kanë fushën e tyre të kompetencave mbi bazën e të cilave nxjerrin aktet e tyre, ligjshmëria e të cilave vlerësohet në procedurë përkatëse, por që nuk mund të jenë objekt i vlerësimit sa i përket ligjshmërisë në procedurën për mbrojtje nga pengimi i posedimit. Në këtë kontekst Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, por jo edhe pjesën e arsytimit të asaj gjykate, citat faqe 4 “sipas vlerësimit të gjykatës veprimit i të paditurës është i drejtë dhe i ligjshëm....”.

Gjykata e Apelit e ka pranuar përfundimin meritor të çështjes por jo me justifikimin se veprimet e të paditurës janë të drejta dhe të ligjshme, por me arsytimin se veprimet e të paditurës nuk përbejnë akt të pengimit të posedimit, ndërsa nëse janë apo nuk janë veprimet e të paditurës të drejta dhe të ligjshme mund të konstatohet në procedurë tjetër gjyqësore.

Pra, në këtë rast pathemelësia e kërkesëpadisë është e përcaktuar nga fakti se veprimet e caktuara në këtë rast për të cilat paditësi pretendon se kualifikohen si akt i pengim posedimit janë ndërmarrë nga një organ i themeluar me ligj i cili ka fushë veprimtari të caktuar përfshirë edhe çështjen e lirit të pronave, prandaj nuk mund të kualifikohen si veprime që konsumojnë elementet e pengimit të posedimit.”

73. Rrjedhimisht dhe siç është elaboruar më lart, Gjykata vëren që të gjitha gjykatat e rregullta kishin konstatuar se veprimet e ndërmarrë nga ana e AKKVP janë të ligjshme për arsye se ky organ është i themeluar me ligj i cili ka fushë veprimtari të caktuar ku përfshihet edhe çështja e lirit të pronave, dhe se veprimet e ndërmarrë nuk paraqesin akt të pengim posedimit.
74. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kishin trajtuar dhe arsyetuar në tërësinë e tyre pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket pengim posedimit dhe se procedurat para gjykatave në rrethanat e rastit konkret, në asnjë mënyrë nuk rezultojnë të kenë qenë të padrejta apo arbitrare.
75. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, duhet pasur parasysh se “drejtësia” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës. (Shih në këtë aspekt, rastet e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
76. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih rastet e Gjykatës KI118/17 parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19,

cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).

77. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimin e ngritur nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
78. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës, dhe nenin 1 të protokollit 1 dhe nenin 13 të KEDNJ-së, mirëpo pa shtjelluar dhe arsyetuar se si dhe pse janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me këto nene të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. (shih, rastin KI 67/16, parashtrues i kërkesës *Lumturije Voca*, Aktvendimi për Papranueshmëri, i 23 janarit 2017, par. 128; KI172/18, parashtrues *Arbër Kryeziu*, pronar i “Al-Petrol” Sh.p.k, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 janarit 2020, paragrafi 65).
79. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht me vendimet e Gjykatës së Apelit, dhe atë të Gjykatës Themelore, apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21.; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
80. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

b) Procedura e zhvilluar pranë Gjykatës Supreme

81. Në lidhje me këtë procedurë, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë kanë të bëjnë me mënyrën e aplikimit të dispozitave ligjore nga ana e Gjykatës Supreme, në mënyrë specifike ankohet se Gjykata Supreme nuk ia ka trajtuar rastin e ngritur para saj me anë të ankesës.
82. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme me Aktgjykimin [GSK-KPA-A-005/19] kishte arsyetuar vendimin e saj duke konstatuar se nuk ka juridiksion për të shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me këtë çështje. Ndër të tjera në vendimin e saj ajo theksoi se :

” Sipas nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut, nr.1999/23, të datës 15 Nëntor 1999, Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë. Vendimi i ankimuar, HPCC/REC/85/2006, është përfundimtar i formës së prerë, dhe në pajtim me nenin 2, paragraf 7, të rregullores së lartëpërmendur nr.1999/23 i njëjti nuk mund të ankimohet, as sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/60 sepse dispozitat e këtyre dy rregulloreve nuk parashohin ndonjë mjet juridik të rregullt apo të jashtëzakonshëm të goditjes të vendimeve përfundimtare të KÇPB.”

83. Tutje Gjykata vëren se Gjykata Supreme i kishte dhënë përgjigje parashtruesit të kërkesës duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut të lartëcekur, ku sipas saj pas vendosjes me vendimin e shkallës së dytë, çështja e vendosur trajtohet “res judicata”, sepse sipas nenit 2.5, të asaj rregullorje në çështjet e pronave banesore, jurisdiksioni i gjykatave lokale ishte përjashtues, ndërsa komisioni ka kompetencë ekskluzive për të zgjidhë kategoritë e kërkesave të theksuara si në nenin 1.2 të kësaj rregullore. Po ashtu Gjykata Supreme i ishte referuar edhe rastit KI104/10 të Gjykatës Kushtetuese, sa i përket vendimeve të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore.
84. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç; nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata rithekson më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih mutatis mutandis, rastin, Akdivar kundër Turqisë, nr. 21893/93, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 16 shtatorit 1996 para. 65, rastin Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar nr. 35394/97, GJEDNJ, Aktgjykim i 4 tetorit 2000, paragrafi 34; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues: Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
85. Gjykata vëren se arsyetimi nga Gjykata Supreme, është i qartë dhe i mbështetur, dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, mutatis mutandis, rastin Shub kundër Lituanisë, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
86. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, Aktvendimin për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, Abdullah Bajqinca, KI136/14, paragrafi 33).

Përfundim

87. Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtresit të kërkesës, sa i përket dy procedurave të zhvilluara duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pa bazuar në pajtim me rregullin 39(2) të Rregullores së Punës.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

88. Gjykata vëren se parashtresi i kërkesës kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme, që të mos ekzekutohen vendimet e Gjykatave dhe KÇBP-së, deri në vendosjen përfundimtare nga Gjykata.
89. Për të miratuar masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 57 (5) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të konstatojë që:

“(5) Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Gjykata do të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.”

90. Siç është konkluduar më parë, kërkesa e parashtresit të kërkesës është qartazi e pa bazuar në baza kushtetuese, prandaj edhe kërkesa e parashtresit të kërkesës për masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullin 39 (2), 57 (5) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË HEDH POSHTË kërkesën për masë të përkohshme.
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

